

ETR2 – Udhëzimi për Llogaritjen e Tarifave

10 Tetor 2007

1 Hyrje

Ky shënim përmbledh qasjen e përgjithshme për llogaritjen e tarifave të propozuara, pas një përlllogaritjeje të të ardhurave vjetore të lejuara, si pjesë e aplikacioneve për tarifa të rregulluara të cilat do të paraqiten nga të licencuarit (KEK SHA dhe KOSTT SHA) në ZRrE sipas shqyrtimit të dytë të tarifës së energjisë elektrike (ETR2). Në një shënim të veçantë përshkruhet llogaritja e të ardhurave vjetore të lejuara.

2 Struktura e Tarifave me Pakicë

Tarifat e energjisë elektrike me pakicë në Kosovë përfshijnë:

- Tarifat e konsumatorit (të shprehura në €/konsumator/muaj). Këto përdoren për të mbuluar kostot e furnizimit që kanë të bëjnë me konsumatorët.
- Tarifat e kërkesës, për konsumatorët me njësim të përshtatshëm (të shprehura në €/kW dhe të aplikuar për kërkesën e njësuar të pikut për secilin muaj). Këto përdoren për të mbuluar ato kosto (fikse) të furnizimit të nxitur nga kërkesa e pikut (pra, sigurimi i rrjeteve dhe kapacitetit gjenerues).
- Tarifat e energjisë (të shprehura në €/kWh, me norma të ndryshme që aplikohen në sezonet e larta dhe të ulëta dhe gjatë kohës së ditës). Këto përdoren për të mbuluar kostot variable të furnizimit (pra, kostot e karburantit të gjenerimit dhe kostot e importimit të energjisë).
- Tarifat e energjisë reaktive, për konsumatorët më të mëdhenj me njësim të përshtatshëm (të shprehura në €/kVArh). Këto përdoren për të mbuluar kostot e sigurimit të energjisë reaktive.

3 Llogaritja e Tarifave me pakicë

Shqyrtimi i parë i tarifës së energjisë elektrike (ETR1) bëri një sërë ndryshimesh të mëdha në strukturën e mëparshme të tarifave me pakicë:

- U futën tarifat e pandryshueshme / konsumatorë.
- U hoqën tarifat e kërkesës për konsumatorët pa njehsim të përshtatshëm (kategoritë 4-6). Më parë, tarifat e kërkesës për këta konsumatorë u trajtuan në mënyrë efektive si ‘shtesë’ ndaj tarifës së energjisë, me një humbje vijuese të çdo sinjali efektiv të çmimit.
- Bilanci midis tarifave të kërkesës dhe tarifave të energjisë (dhe për konsumatorët më të mëdhenj, tarifat e energjisë reaktive) u rregulluan për të pasqyruar më mirë ndarjen e kostove fikse dhe atyre të ndryshueshme të furnizimit dhe të mbulimit të kostove që kishin të bënin me konsumatorët sipas një tarife të re të pandryshueshme.

Qasja e përgjithshme e ndërmarrë ishte për të alokuar të ardhurat vjetore të lejuara në kostot që kishin të bënin me konsumatorët, kostot që kishin të bënin me kërkesën dhe që kishin të bënin me energjinë, në varësi të nxitësit kryesor të kostove. Këto kosto më pas u shpërndanë midis kategorive individuale të tarifave në raport me pjesën e tyre të numrave të konsumatorëve, përkatësisht kërkesën e rastësishme të pikut dhe vëllimet e energjisë (pra një qasje e kostove të shpërndara ose të ngulitura). Më shumë detaje për qasjen e ndërmarrë për të llogaritur çdo përbërës individual të tarifave, është dhënë më poshtë.

3.1 Tarifat e pandryshueshme/ konsumatorë

Tarifat e pandryshueshme/ konsumatorë janë llogaritur si vijon:

- Tarifat e pandryshueshme/ konsumatorë janë llogaritur si kosto të shpërndara që kanë të bëjnë me konsumatorët pjesëtuar me numrin e parashikuar të konsumatorëve në secilën kategori.
- Kosto të shpërndara që kanë të bëjnë me konsumatorët janë llogaritur si kosto të totale që kanë të bëjnë me konsumatorët shumëzuar për çdo ndarje të kategorisë së numrit total të konsumatorëve.
- Kosto totale që kanë të bëjnë me konsumatorët janë llogaritur si shuma e tepricës së lejuar të furnizimit dhe kostove të pakicës së Furnizimit të KEK-ut e cila iu ngarkohet konsumatorëve të rregulluar

3.2 Tarifat e Kërkesës

Tarifat e kërkesës janë llogaritur si vijon për konsumatorët në kategoritë 0-3 (konsumatorë të mëdhenj industrialë dhe komercialë):

- Tarifa e kërkesës është llogaritur si kosto të shpërndara që kanë të bëjnë me kërkesën pjesëtuar me shumën e kërkesës së pikut të parashikuar për kategorinë e konsumatorit në çdo muaj.

- Kosto të shpërndara që kanë të bëjnë me kërkesën janë llogaritur si kosto totale që kanë të bëjnë me kapacitetin në secilin nivel të tensionit, të shumëzuar me pjesën e secilës kategori të konsumatorëve në kërkesën e rastësishme të pikut për atë nivel tensioni.
- Kosto totale të kapacitetit janë llogaritur si shuma e kostove të blerjes me shumicë të energjisë shumëzuar me raportin e supozuar të kostove të kapacitetit¹ në këto, plus tarifën e infrastrukturës së rrjetit SHST (TUOS) plus tarifën e infrastrukturës së rrjetit SHSSH (DUOS) shumëzuar me faktorin² e rregullimit të ndarjes së kapacitetit /energjisë.

Për konsumatorët e tjerë, kosto të shpërndara që kanë të bëjnë me kërkesën janë llogaritur si më sipër. Më pas këto i shtohen tarifave të energjisë, siç përshkruhet më poshtë.

3.3 Tarifat e energjisë

Tarifat e energjisë për konsumatorët në kategoritë 0-3 (konsumatorë të mëdhenj industrialë dhe komercialë) janë llogaritur si vijon:

- Tarifat e energjisë në secilën periudhë (e lartë në dimër, e ulët në dimër, e lartë në verë, e ulët në verë) janë llogaritur si kosto totale që kanë të bëjnë me energjinë të cilat do të mbulohet në atë periudhë nga çdo kategori e konsumatorëve, pjesëtuar me shitjet e parashikuara për atë kategori konsumatorësh në atë periudhë të dhënë.
- Kostot e energjisë që do të mbulohen në secilën periudhë janë llogaritur si kosto totale që kanë të bëjnë me energjinë në vit, shumëzuar me faktorin e shpërndarjes.
- Faktori e shpërndarjes llogaritet si:
 - Produkti i koston së përlllogaritur marxhinale afatshkurtër (SRMC) në secilën periudhë, dhe shitjet e energjisë në atë periudhë për çdo kategori konsumatorësh.
 - Produkti përfundimtar pjesëtohet me totalin e të ardhurave vjetore sipas tarifave SRMC (pra shuma e produktit të SRMC në secilën periudhë shumëzohet me shitjet totale të energjisë në secilën periudhë).
- Kostot totale të energjisë janë llogaritur si shuma e operatorit të lejuar të tregut (OT) dhe kostot e operatorit të sistemit (OS) të shpërndara tek konsumatorët jo të

¹ E vendosur për 30% nga KEMA (konsulentët e ZRRE-së për ETR1).

² Ky faktor përcakton raportin e kostove të shpërndarjes për kërkesën të cilat janë shpërndarë me tarifën e kërkesës. Është caktuar me 100% për kategoritë 1-2 dhe 0% për kategoritë 3-4 (pra të gjitha kostot e rrjetit të shpërndarjes për këto kategori janë shpërndarë sipas tarifave të energjisë.).

privilegjuar dhe kostot totale të blerjes së energjisë, minus pjesën që konsiderohet se ka të bëjë me kërkesën (shih më sipër).

Për konsumatorët e tjerë, kostot e shpërndara të kërkesës më pas i shtohen tarifave të energjisë të llogaritura si më sipër. Përbërësi i kapacitetit të kostove të blerjes së energjisë i shtohet tarifave të energjisë të aplikuar në periudhat e larta (dimër dhe verë). Përbërësi i kapacitetit të tarifave SHST dhe SHSSH i shtohet tarifave të energjisë të aplikuar në të gjitha periudhat.

Për konsumatorët shtëpiakë (kategoritë 5-6), janë bërë dy ndryshime të mëtejshme³:

- Për të mbajtur raportin ekzistues midis tarifave të periudhave të ulëta dhe të larta i cili është dy me një (vendim i marrë për të rritur pranueshmërinë), tarifat e sezonit të lartë dhe të ulët janë rillogaritur në mënyrë që raporti midis dy periudhave në secilin sezon të mbetet sërish dy me një.
- Është miratuar struktura me tre blloqe. Tarifat në secilin bllok janë llogaritur duke përcaktuar tarifën e lejuar të energjisë në dy blloqet më të ulët, si përqindje e tarifës së energjisë që pasqyron kostot (e përcaktuar me 70% për bllokun e parë dhe 100 % për bllokun e dytë). Tarifat e energjisë për të tretin, që është më i lartë, më pas rillogariten në mënyrë që të ardhurat vjetore totale të mbuluara prej tarifave të energjisë të vendosura ndaj konsumatorëve shtëpiakë të mbeten të pandryshuara.

3.4 Tarifat e energjisë reaktive

Tarifat e energjisë reaktive për konsumatorët në kategoritë 1-3, janë llogaritur si:

- Shuma e kostove të shpërndara të energjisë reaktive të pjesëtuar me energjinë reaktive totale të njehsuar (në kVARh).
- Kostot e shpërndara të energjisë reaktive janë llogaritur si kosto të energjisë reaktive në secilin nivel tensioni (këto i ngarkohen plotësisht atyre konsumatorëve që janë përgjegjës për tarifat e energjisë reaktive).
- Kostot e energjisë reaktive në secilin nivel tensioni janë llogaritur si kosto totale të shpërndarjes sipas tensionit shumëzuar me pjesën e supozuar të kostove të energjisë reaktive për këto⁴.

³ Ka edhe një rregullim të mëtejshëm për të shndërruar tarifat përfundimtare të dy periudhave dhe dy sezoneve në një tarifë për një sezon dhe një periudhë për konsumatorët me njehsorë një-normësh .

⁴ Kjo ndarje ka qenë caktuar nga KEMA me 6% për rrjetin 35kV, 30% rrjetin 10kV 2% për rrjetin e TU.

3.5 Përshtatjet e Përballueshme

Tarifat rezultuese që pasqyrojnë kostot të llogaritura si më sipër i janë nënshtruar përshtatjeve të mëtejshme për t'i pajtuar ato me shqetësimet për përballueshmërinë e tyre. Këto përshtatje marrin formën e faktorëve shkallëzues me të cilat shumëzohen tarifat që pasqyrojnë kostot. Në përcaktimin e këtyre faktorëve shkallëzues janë miratuar parimet kryesore vijuese:

- Faturat mesatare për konsumatorët shtëpiakë në dy blloqet më të ulëta të konsumit nuk duhet të rrisë prej nivelit të tyre sipas tarifës që ka ekzistuar më herët, duke rezultuar në aplikimin e një rregullimi prej së poshtmi.
- Fatura mesatare për konsumatorët shtëpiakë në bllokun e tretë dhe më të lartë të konsumit nuk duhet të rritet me më shumë se 10% prej nivelit të tyre sipas tarifave që kanë ekzistuar më herët.
- Tarifat për konsumatorët e tjerë duhet të rregullohen nga sipër për të kompensuar humbjet rezultuese të të ardhurave vjetore.

4 Llogaritja e Tarifave SHST

Tarifat e Shfrytëzimit të Sistemit të Transmetimit (SHST) mbulojnë kostot e KOSTT. Ka tre tarifa të ndryshme:

- Tarifa e kapacitetit (infrastrukturës). Kjo mbulon kostot e KOSTT për funksionimin, mirëmbajtjen dhe investimin në rrjetin e transmetimit. Tarifa llogaritet si totali i kostove të infrastrukturës që shkakton KOSTT, pjesëtuar me kërkesën totale të pikut të rastësishëm në sistemin e transmetimit, për të dhënë një tarifë të shprehur në €/kW/vit. Tarifa aplikohet vetëm ndaj furnizuesve (pra një ndarje prej G=0% / L=100%). Konsumatorët në 110kV paguajnë tarifën e aplikueshme për atë nivel si dhe për nivelin 220/400kV. Konsumatorët me nivel më të lartë tensioni paguajnë vetëm atë tarifë të aplikueshme për atë nivel.
- Tarifa e operatorit të sistemit. Kjo mbulon kostot e KOSTT në rolin e vet si OS, duke përfshirë blerjen e shërbimeve ndihmëse dhe humbjet. Tarifa është llogaritur si kosto totale që ka të bëjë me OS-në, pjesëtuar me shumën e energjisë së parashikuar që hyn në sistemin e transmetimit nga burimet kosovare dhe që del nga sistemi i transmetimit në të gjithë pikat⁵, për të dhënë një tarifë të shprehur në €/kWh. Kjo paguhet nga prodhuesit dhe furnizuesit.
- Tarifat e operatorit të tregut. Kjo mbulon kostot e KOSTT në rolin e vet si OT. Tarifa është llogaritur si kosto totale që ka të bëjë me OT-në, pjesëtuar me

⁵ Ky përkufizim siguron që rrjedhat e transitit t'i paguajnë tarifat e OS vetëm një herë (në daljen nga sistemi).

shumën e energjisë së parashikuar që hyn në sistemin e transmetimit nga burimet kosovare dhe që del nga sistemi i transmetimit në të gjithë pikat, për të dhënë një tarifë të shprehur në €/kWh. Kjo paguhet nga prodhuesit dhe furnizuesit.

5 Llogaritja e Tarifave SHSSH

Janë llogaritur tarifa të veçanta SHSSH por nuk janë aplikuar sipas ETR1. këto përfshijnë tarifatat vijuese:

- Tarifa e energjisë. Kjo mbulon kostot e Shpërndarjes së KEK-ut të lidhura me humbjet në blerjen e shpërndarjes. Është llogaritur si pjesë e këtyre kostove të shpërndara ndaj çdo kategorie konsumatorësh, pjesëtuar me energjinë e parashikuar të furnizuar tek ajo kategori, për të dhënë një tarifë të shprehur në €/kWh. Shpërndarja e kostove është përcaktuar nga pjesa përkatëse e secilës kategorie konsumatorësh në energjinë që hyn në sistemin e shpërndarjes (e llogaritur si konsum i njehsuar ‘bruto’ nga humbjet)
- Tarifa e energjisë reaktive. Kjo mbulon kostot e Shpërndarjes së KEK-ut për sigurimin e energjisë reaktive. Është llogaritur siç është përshkruar në seksionin **Error! Reference source not found.**, sipër.
- Tarifa e kërkesës. Kjo mbulon kostot mbetëse të Shpërndarjes së KEK-ut. Është llogaritur si kosto marginale totale afatgjatë (LRMC)- të ardhurat vjetore bazë në secilin nivel tensioni minus pjesën e mbuluar nga tarifatat e energjisë reaktive, pjesëtuar me kërkesën e pikut të rastësishëm në atë nivel, për të dhënë një tarifë të shprehur në €/kW/vit. Të ardhurat vjetore të bazuara në LRMC janë llogaritur si:
 - LRMC e përlllogaritur e shpërndarjes në secilin nivel tensioni, shumëzuar me kërkesën e atij niveli tensioni, dhe më pas shumëzohet me një koeficient rregullimi për të ardhurat vjetore (për t’i harmonizuar të ardhurat vjetore LRMC me të ardhurat vjetore të lejuara).
 - LRMC në secilin nivel tensioni llogaritet si koeficienti LRMC për çdo nivel, plotësuar nga humbjet marginale që hasen në çdo nivel dhe nga faktori i koincidencës së kërkesës në atë nivel. Këto mblidhen (‘grumbullohen’) për nivele më të ulëta tensioni (pra, LRMC në 10kV është shuma e koeficientit të rregulluar të LRMC në 35kV dhe 10kV).
 - Koeficienti LRMC për çdo nivel tensioni llogaritet si shuma e kostos vjetore të operimit dhe mirëmbajtjes dhe kostos mesatare rritëse afatgjatë (LRAIC) në secilin nivel tensioni.
 - LRAIC në çdo nivel tensioni është llogaritur si vlera aktuale e investimeve në atë nivel, pjesëtuar me ngarkesën e shërbyer në rritje, ku rezultati përshtatet në afate vjetore (duke përdorur një jetë të supozuar 20 vjeçare të Asetit dhe mesataren e Ponderuar të kostos së kapitalit).